



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.12..2019, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik 2018 për projektin “Menaxhimi i modernizuar i mbetjeve dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit””.
2. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97, datë 04.03.2013, “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.
3. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.
4. Seancë dëgjimore me përfaqësues të botës akademike dhe përfaqësues të fushës së gjyqësorit, prokurorisë dhe avokatisë.
5. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97, datë 04.03.2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.
6. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.
7. Seancë dëgjimore me përfaqësues të shoqatave e medias dhe gazetarë.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Damian Gjiknuri, Aurora Mara, Ediola Braha, Elena Xhina, Adriatik Alimadhi dhe Andi Përmeti.

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Edmond Leka, Alban Zeneli, Elda Hoti, Nikolin Staka dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Blendi Klosi – Ministër i Turizmit

Adrian Kamenica – Sekretar i Përgjithshëm

Redi Baduni – Drejtor i Drejtorisë së Projekteve Mjedisore në Ministrinë e Turizmit

Maksim Qoku – Nënkyetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor

Kujtim Luli – Prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme

Elvin Luku – Përfaqësues nga Qendra Shqiptare MediaLook

Ilda Londo – Përfaqësuese nga Instituti Shqiptar i Medies

Kristina Voko - Drejtoreshe Ekzekutive e BIRN Albanias

Elona Gjylmi – Gazetare në A2CNN

Klesjana Omeri – Gazetare në Report TV

Ardit Hoxha - Gazetar në gazetën “Panorama”

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi është i pranishëm për të vazhduar me çështjet që kemi sot në rendin e ditës. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik 2018 për projektin “Menaxhimi i modernizuar i mbetjeve dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit””.

Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relator do të jetë kolegu Edmond Leka. Kemi prezent nga Ministria e Turizmit zotin ministër, Blendi Klosi.

Zoti Klosi, mirë se keni ardhur në Komisionin e Ligjeve!

Ju lutem, bëni një prezantim të shkurtër të kësaj marrëveshjeje për kolegët e mi të komisionit! Më pas do ta marrë fjalën relatori, zoti Leka, dhe do të vazhdojmë pastaj me pyetjet dhe diskutimet nga kolegët. Pa humbur kohë, meqenëse ministri ka edhe mbledhje qeverie në orën 12:00, po ia jap fjalën për të bërë prezantimin e marrëveshjes.

Urdhëroni!

Blendi Klosi – I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë,

Jemi në dakordësi me një pjesë të kolegëve, pasi ky projektligj u diskutua sot edhe në Komisionin e Ekonomisë dhe në Komisionin e Jashtëm.

Projekti vjen si një dakordësi e qeverisë shqiptare me qeverinë gjermane, për të vazhduar më pas në fazën e tij të tretë për menaxhimin e modernizuar të mbetjeve dhe të ekonomive ricikluese në respekt të mjedisit. Është një përpjekje e gjatë e qeverisë gjermane për të ndihmuar qeverinë shqiptare dhe institucionet e mjedisit në kuadër të trajtimit të mbetjeve urbane. Ky projekt, i cili vjen për një fazë 3-vjeçare, një investim ose një ndihmesë me 4,5 milionë euro nga qeveria gjermane nëpërmjet agjencisë implementuese GIZ OVG 20 për sa i përket ndihmesës që do të japin bashkitë e vendit, kërkon asistencë për ngritjen e

kapaciteteve në disa nga bashkitë e përcaktuara në këtë projekt. Po ashtu, edhe për institucionet e mjedisit. E para.

E dyta, ka një përafrim dhe zbatim të legjislacionit mjedisor, për të pasur një trajtim më të standardizuar, por edhe më efikas të mbetjeve urbane në zonat e bashkive të nivelit të dytë, si dhe përgatitjen e këtyre bashkive për të shkuar në venddepozitimin e mbetjeve urbane në *landfillet* kryesore të vendit.

E treta, një dimension shumë i rëndësishëm i këtij projekti janë investimet konkrete, që do të bëhen në 6 bashki për sa i përket asistimit të tyre me mekanizma apo me mjete për të trajtuar mbetjet urbane siç duhen, por edhe investime në 6 bashki të tjera, që kanë të bëjnë me venddepozitimet e përkohshme apo me venddepozitimet standarde, që duhet të kemi në trajtimin e mbetjeve urbane në vendin tonë.

Ministria e Mjedisit e ka sfidë të vetën që në vitin 2020, 61 bashkitë e vendit të kenë një trajtim të standardizuar, por edhe të licencuar të mbetjeve urbane, pasi në shkallë vendi kemi një situatë jo fort korrekte, pasi vetëm 4 landfille nga 200 venddepozitime kanë leje urbane, leje nga bashkitë, por edhe leje mjedisore, prandaj do të vazhdojmë të punojmë me donatorë të ndryshëm, për t'i zgjidhur të 61 bashkitë brenda vitit 2020 me investime, që vijnë nga buxheti i shtetit, nga donatorë, por edhe nga investime që vijnë nga pushteti lokal. Komisioni juaj i nderuar ka edhe dimensionet e pushtetit lokal. Besoj se do të duhet që në një moment të caktuar të diskutojmë se si reagon pushteti lokal karshi trajtimit të mbetjeve urbane dhe të problematikave për të lehtësuar këtë proces. Pra, këto janë tri fushat e këtij projektit, i cili shtrihet në 3 vjet dhe ka një kapacitet prej 4,5 milionë eurosh dakordësi, për të ndihmuar një sërë bashkish, por më tepër se kaq, për të trajtuar në mënyrë shumë më tepër të avancuar dhe bashkëkohore sistemin e menaxhimit urban të mbetjeve në zona të caktuara të vendit.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Ministër!

Zoti Leka, urdhëroni!

Edmond Leka – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër, për sqarimin tuaj!

Ulsi Manja – Ju lutem, një sekondë!

T'i japim leje ministrit, pasi në orën 12:00 do të zhvillohet mbledhja e qeverisë, për të vazhduar me sekretarin e Përgjithshëm dhe me drejtorin e Drejtorisë së Projekteve.

Besoj se e kam mirëkuptimin tuaj!

Faleminderit, zoti Klosi!

Vazhdoni, zoti Leka.

Edmond Leka – Projektligji vjen si nismë e Këshillit të Ministrave dhe parashikon ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik 2018 “Për menaxhimin e modernizuar të mbetjeve dhe ekonominë ricikluese në respekt të mjedisit”.

Qeveria gjermane ka vënë në dispozicion për projektin, me shpenzimet e saj, shërbime në personel, në materiale, dhe eventualisht kontribute financimi me vlerë rreth 4,5 milionë euro. Detajet e projektit, detyrimet dhe shërbimet që do të kryhen nga palët, do të përcaktohen në një kontratë të veçantë zbatimi, që do të nënshkruhet ndërmjet GIZ-it dhe agjencisë zbatuese të projektit, si dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në cilësinë e institucionit përfitues të asistencës teknike.

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe me Rregulloren e Kuvendit.

Unë kam një pyetje, zoti kryetar, sepse jemi të paqartë për detajet. Këtu thuhet: “Detajet e projektit dhe detyrimet që do të kryhen, do të përcaktohen në një kontratë të veçantë”, mirëpo nuk jemi të qartë se si do të zbatohet kjo marrëveshje, e para.

E dyta, si do të jenë afatet?

Çfarë parashikohet për bashkitë? A kanë detyrime bashkitë për caktimin e zonave se ku do të zbatohet dhe implementohet ky projekt? Këto nuk janë të qarta në relacionin që ne kemi për këtë projektligj.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Ju lutem, prezantohuni!

Adrian Kamenica - Ky projekt do të shtrihet për një periudhë kohore 3-vjeçare dhe bashkitë nuk do të kenë detyrime financiare. Ky është qëllimi pse kemi zgjedhur bashkitë e nivelit të dytë, le të themi, pasi ato nuk kanë kapaciteteve për të vënë diçka në dispozicion. E vetmja gjë që do të vënë në dispozicion janë venddepozitimet e përkohshme dhe administrata, e cila do të trajnohet për të pasur rritje kapacitetesh.

Pra, për sa i përket marrëveshjes së zbatimit, ne do miratojmë në nivel parlamenti marrëveshjen e zbatimit, kurse detajet do të jepen në një moment të dytë midis GIZ-it dhe ministrisë sonë, por gjithsesi do të jenë gjithmonë transparente.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Zoti Leka.

Edmond Leka – Kam një pyetje.

A mund t’i identifikoni bashkitë që do të implementohen në këtë projekt?

Adrian Kamenica – Bashkia e Himarës, Bashkia e Peqinit, Bashkia e Roskovecit, Bashkia e Cerrikut dhe Bashkia e Sarandës. Këto bashki u zgjodhën nga vetë projekti për shkak

të mungesës së kapaciteteve. Të themi të drejtën, Bashkinë e Sarandës e iniciuam ne për shkak të turizmit.

Ulsi Manja – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera nga kolegët?

Zonja Bode.

Ju lutem, mbani qetësi!

Edlira Bode – Faleminderit për të gjithë informacionin!

Ndoshta edhe nuk ka shumë lidhje me marrëveshjen, por unë dua të di: në shkallë republike ku jemi me menaxhimin e mbetjeve dhe cilat janë bashkitë që pas këtij projekti, pra që nuk janë të përfshira në këtë projekt, mbeten problematike në Shqipëri?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Zoti Kamenica.

Adrian Kamenica – Siç e tha edhe ministri më parë, ne kemi filluar me fazën e parë të projektit, që është një studim i të gjithë territorit dhe kemi evidentuar rreth 200 venddepozitime që duhen trajtuar për 61 bashkitë. Momentalisht, kjo është faza e parë që ne po angazhojmë një donator direkt për të mundësuar rehabilitimin e venddepozitimeve, që do të thotë se nga 61 bashki, këto janë 6 bashkitë e para. Po vazhdojmë bashkëpunimin me të gjithë donatorët e tjerë për t'i angazhuar, secili sipas zonave të veta, që të vijojnë me rehabilitimin e tyre.

Edlira Bode – Kjo do të thotë se nga 61 bashki, ne nuk kemi një të vetme që aktualisht i menaxhon siç duhet?

Adrian Kamenica – Momentalisht, siç u tha edhe më parë, janë bërë hapa konkret në 4 bashki të mëdha. Një ndër bashkitë është ajo e Korçës, e cila ka avancuar më tepër nga të gjithë në bashkëpunim me KfW-në dhe me qeverinë gjermane. Bashkitë e tjera po vijojnë të rehabilitohen.

Ulsi Manja – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

A ka diskutime? Nuk ka.

E hedhim në votim në parim projektligjin.

Kush është dakord në parim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik 2018 për projektin “Menaxhimi i modernizuar i mbetjeve dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit””.

Kalojë në shqyrtimin dhe miratimin nen për nen të kësaj marrëveshjeje.

Neni 1. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është dakord në tërësi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Relatori dhe këshilltari i komisionit të bëjnë gati raportin për komisionin përgjegjës dhe më pas kjo marrëveshje do të kalojë për votim në seancën plenare të datës 18 dhjetor.

Faleminderit, zoti Kamenica dhe zoti Baduni, për prezencën tuaj sot në komision!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.12.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97, datë 04.03.2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar” si dhe për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Damian Gjikhuri, Aurora Mara, Ediola Braha, Elena Xhina, Adriatik Alimadhi dhe Andi Përmeti.

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Edmond Leka, Alban Zeneli, Elda Hoti, Nikolin Staka dhe Tom Doshi.

Ulsi Manja - Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës me vazhdimin e seancave dëgjimore për dy projektligje.

Kemi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97, datë 04.03.2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar” dhe projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”.

Ne jemi komision për dhënie mendimi. Relatore të këtyre projektligjeve, që njihen edhe si paketa antishpifje, janë kolegja Klotilda Bushka dhe zonja Hysi.

Sot kemi përfaqësues nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe nga Prokuroria e Përgjithshme. Nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kanë konfirmuar pjesëmarrjen zoti Maksim Qoku, nënkryetar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë duke ardhur.

(Diskutime pa mikrofon)

(Mungesë incizimi)

Ju lutem!

Nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ka konfirmuar pjesëmarrjen nënkryetari, zoti Maksim Qoku, por konfirmon se mendimet për këto dy projektligje do t’i sjellë me shkrim.

Nga Prokuroria e Përgjithshme ka konfirmuar pjesëmarrjen zoti Kujtim Luli, i cili po vjen, por deri në mbërritjen e përfaqësuesit të Prokurorisë së Përgjithshme, do të bëjmë 10 minuta pushim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.12.2019, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me përfaqësues të botës akademike dhe përfaqësues të fushës së gjyqësorit, prokurorisë dhe avokatisë në kuadër të shqyrtimit projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”” dhe projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Damian Gjiknuri, Aurora Mara, Ediola Braha, Elena Xhina, Adriatik Alimadhi dhe Andi Përmeti.

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Edmond Leka, Alban Zeneli, Elda Hoti, Nikolin Staka dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Kujtim Luli – Prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme

Zhaklina Peto - Profesoreshë e pronësisë intelektuale pranë Fakultetit të Drejtësisë

Kestrin Katro - Zëvendësdekane e Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranë

Ulsi Manja – Të futet media.

Rifillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve me pikën e dytë të rendit të ditës, vazhdimi i seancave dëgjimore me përfaqësues të botës akademike dhe përfaqësues të fushës së gjyqësorit, prokurorisë dhe avokatisë.

Nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kemi konfirmimin se do të na sillen me shkrim opinionet e tyre në lidhje me dy projektligjet e paketës “antishpifje”. Të pranishëm janë zoti Kujtim Luli, prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme, nga bota akademike zonja Zhaklina Peto, profesoreshe e pronësisë intelektuale pranë Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës dhe zonja Kestrin Katro, zëvendësdekane e Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës.

Mirë se keni ardhur në Komisionin e Ligjeve!

Në fakt, Komisioni i Ligjeve si komision për dhënie mendimi ka disa ditë që zhvillon seanca dëgjimore me përfaqësues të shoqërisë civile, të botës akademike, të fushës së gjyqësorit, prokurorisë, avokatisë, me përfaqësues së shoqatave të medie dhe të gazetarëve, të cilët do të jenë pak më pas, në lidhje me dy projektligje të rëndësishme, të cilat janë në agjendën parlamentare që nga korriku i vitit 2019. Konkretisht bëhet fjalë për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97, datë 04.03.2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Natyrisht që komisioni ynë është komision për dhënie mendimi dhe do të japë një opinion ligjor për komisionin përgjegjës që është Komisioni Për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Këto seanca dëgjimore zhvillohen në funksion të marrjes së mendimit të ekspertëve të ndryshëm gjithmonë në funksion të një qëllimi, të përmirësimit të drafteve ligjore që do të kalojnë në seancë plenare. Besoj se me draftet jeni njohur. Nuk e di se kush e do fjalën e parë për të na bërë një prezantim, opinion apo komentet lidhur me këto dy projektligje.

Mund ta merrni fjalën se jemi në një seancë dëgjimore dhe prandaj ju kemi ftuar për t’ju dëgjuar.

Po, zonja Peto.

Zhaklina Peto – Faleminderit!

Përshëndetje të gjithëve!

Do të doja që diskutimin tim ta nis me qasjen që Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka në lidhje me lirinë e shprehjes: “Liria e shprehjes është një gur themeli në një shoqëri demokratike, por ajo nuk bën pjesë në ato të drejta, të cilat janë absolutisht të pakufizueshme”. Kjo do të thotë që kjo e drejtë mund të jetë subjekt i ndërhyrjeve nga ana e autoriteteve publike vetëm nëse respektohen disa kritere, por do të fokusohem te kriteri i parë, që është më i rëndësishmi, i cili ka të bëjë me atë që kufizimi i lirisë së shprehjes duhet të jetë i parashikuar në ligj. Pikërisht, kjo është edhe arsyeja që ndodhemi këtu sot, për të parashikuar me ligj disa format e kufizimit të lirisë së shprehjes.

Projektligji, të cilin do të diskutojmë është pikërisht baza ligjore e nevojshme për të garantuar një ndërhyrje në përputhje me standardet europiane të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore. Problemi i legjislationit në përgjithësi qëndron në faktin se sa i qartë dhe i saktë duhet të jetë ligji në mënyrë që ndërhyrja ligjore që do të bëhet nga ana e autoriteteve publike të jetë e tillë që të mos cenohet dhe të abuzohet në drejtim të lirive dhe të medieve. Përsëri në frymën e Gjykatës Europiane do të thotë që ligji duhet të jetë i qartë, i detajuar dhe të ketë një nivel të lartë të parashikueshmërisë të pasojave që do të sjellë ky ligj te subjektet e tij, si dhe të jetë i kuptueshëm në atë nivel, ku çdo person që e lexon këtë ligj duhet ta kuptojë në mënyrë të menjëhershme se cilat janë pasojat që vijnë nga ky ligj.

Unë do ta konsideroja këtë projektligj si risi në tre drejtime kryesore.

Së pari, zgjeron objektin e veprimtarisë së shërbimeve elektronike, një trend, i cili është zhvilluar shumë kohët e fundit.

Së dyti, harton një kornizë ligjore në lidhje me shërbimet elektronike si një domosdoshmëri, e cila duhej të ishte bërë prej kohësh, pra jemi shumë të vonuar shumë sa i takon rregullimit juridik të shërbimeve elektronike.

Së treti, vjen në një moment shumë të rëndësishëm me qëllimin e mirë për të kornizuar ligjërisht balancën ndërmjet lirisë së shtypit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të individit. Megjithatë, pa zbehur aspak qëllimin e mirë dhe të qenit pro këtij projektligji në parim, meqenëse ndodhemi në fazën e parë të diskutimeve, kemi ende mundësi për të sugjeruar disa mendime në lidhje me efektshmërinë e këtij ligji. Për këto arsye po ju bëj disa sugjerime të aspektin teknik në lidhje me përmirësimin e këtij projektligji.

E para, dua t'ju tërheq vëmendjen në lidhje me ekzistencën e dy ligjeve, njëri prej të cilëve lidhet me komunikimet elektronike, i cili në thelb të tij përjashton nga fusha e zbatimit përmbajtjen e shërbimeve të ofruara nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik ose siç i njohim ndryshe kontenit, por nga ana tjetër licencën mediave elektronike. Me kontenit në përmbajtje merret ligji tjetër për mediet audiovizive dhe në praktikë shohim që sot po ballafaqohemi me dy ligje që veprojnë, njëri për licencimin e medieve dhe ka disa kompetenca në lidhje me mediet elektronike, shërbimet elektronike, si dhe ligji i medieve audiovizive, i cili ka përsëri disa kompetenca të tjera në lidhje me shërbimet elektronike.

Dyshoj dhe mendoj se do të kemi pak kakofoni mbivendosjeje kompetencash ndërmjet këtyre dy ligjeve. Ndoshta mund të mund të jetë e tepër të themi që mund t'i mbledhim këto dy ligje dhe t'i bëjmë të funksionojnë si një trup i vetëm. A jemi në kushte për ta bërë këtë sot? Kjo është diçka që ligjvënësit mund ta analizojnë dhe ta shohin si një variant. Do të thoni ju: a ekziston një eksperiencë e tillë? Po. Përveç Francës, e cila funksionon me dy ligje të ndara, ajo për komunikimet elektronike dhe mediat audiovizive, në një pjesë e konsiderueshme e vendeve të Europës funksionon me të dyja ligjet së bashku, duke i bashkuar këto ligje në një. Përse kjo gjë? Pikërisht për faktin e mbivendosjes së kompetencave nëpërmjet ligjeve. Kjo mund të krijojë një rrezik në lidhje me të kuptuarit e ligjit, duhet të jemi pak më preciz, sepse ky është një ligj shumë sensitiv, jo se ligjet e tjera nuk janë, por duke qenë se kemi të bëjmë me lirinë e medias.

Unë mendoj se në ligj duhet të dalë në pah shumë qartë se kush do ta marrë vendimin për pezullimin apo për mbylljen e këtyre medieve në rast të konstatimit të shkeljeve, nëse kemi të bëjmë me kryetarin apo me bordin. Personalisht jam e qartë që kemi të bëjmë me bordin nga

pikëpamja e mënyrës sesi organizohet, por do të doja sa u takon ndryshimeve, që ky element të ishte saktësuar qartë edhe në projektligj.

Do të duhet të evidentohet qartë se cili është drejtimi që ne duhet t'i japim këtij organi, pra AMA-s. A i kemi dhënë ne AMA-s aktualisht, nëpërmjet bordit, fuqinë për t'i mbyllur mediet në rast se konstatohen ndalime, të cilat janë parashikuar në nenin 132? Cili do të jetë diskrecioni i AMA-s? A nuk do të ishte mirë që të ishte menduar që AMA të kishte një diskrecion dhe të funksiononte *quazi* gjykatë, pra t'i jepeshin edhe disa tagra të tjerë, në mënyrë që vendimet që do të merrte bordi i medias të ishin vendime që të ankimoheshin në Gjykatën Administrative të Apelit, pra të mos fillonte kalvari në Gjykatën e Shkallës së Parë, sepse kështu do të shkonim në një zgjatje pa fund të procedurës së pezullimit apo të përfundimit.

E treta, dua t'i referohem nenit 132 të këtij projektligji në të cilin përcaktohen rastet e bllokimit të aksesit në internet nga AKEP-i të medieeve elektronike. Projektligji rendit tre raste, të cilat në kuptimin e ligjit penal janë pjesë e veprave penale: rasti i veprave pornografike, rasti i veprave terroriste dhe shkelja e sigurisë kombëtare.

Gjithashtu, është parashikuar që bordi i AMA-s do të mblidhej edhe brenda 5 ditëve nëse konstaton se kemi të bëjmë me një nga këto vepra penale dhe do të marrë vendimin për të pezulluar median, e cila ka realizuar një nga këto vepra penale. Në fakt, mendoj se këtu kemi një kapërcim të ndërhyrjes së këtij ligji në Kodin Penal. Këto janë vepra, të cilat cilësohen dhe vlerësohen nga Kodi Penal dhe AMA nuk mundet që nëpërmjet një veprimtarie administrative procedurale të ndërhyjë dhe të marrë vendime për këto vepra. Nëse ne duhet ta presim AMA-n 5 ditë për të ndërhyrë kur konstaton rastin e veprës terroriste dhe të sigurisë kombëtare, këtu ka një pikëpyetje, a është AMA autoriteti i profilizuar që mund ta bëjë këtë gjë, e bën brenda orës. Prokurori merr informacionin shkon në gjykatë dhe e mbyll çështjen, ndërsa AMA nuk është gjykatë që të veprojë për ato vepra, të cilat janë objekt i ligjit penal.

Dua të theksoj faktin se të gjitha shkeljet e mësipërme nuk mund të jenë objekt i vendimmarrjes administrative të AMA-s, prandaj do të doja që këtë gjë ta rishikonit dhe ta moderonit deri diku.

E katërta dhe e fundit, ndoshta u zgjata pak, por nga meraku për të bërë diçka teknike, dua ta përqendroj fokusin tek analiza e riskut ligjor. Jam e bindur, sepse kur lexova relacionin pashë që diku ishte analizuar pjesa e buxhetit, pra ishte arritur deri diku në një analizë ligjore e gjithë veprimtaria për hartimin e këtij projektligji. Kam një pyetje më tepër nga pikëpamja e doktrinës, sepse ne, si pedagogë, e fokusojmë më shumë vëmendjen te pjesa shkencore e gjësë, Kuvendi i Shqipërisë duhet të garantojë që ky ligj është në përputhje me Kushtetutën dhe të drejtat dhe liritë themelore. Pse? Sepse ky fakt është shumë i rëndësishëm.

Ne vërtet themi që po i marrim dhe po i dërgojmë mediet elektronike tek AMA se nuk kemi ngarkesë në buxhetin e shtetit, por nëse një palë e interesuar konteston vendimin e AMA-s në gjykatë apo bëhet objekt i shqyrtimit në Gjykatën Kushtetuese, te ligji që do të dalë, kush nga garanton që në përmbajtjen e këtij ligji nuk ka elemente të shkeljes së Kushtetutës apo të të drejtave dhe lirive themelore, të cilat në përfundim kanë një vlerë, një barrë, një shpërblim monetar të caktuar, e cila në analizën ligjore konsiderohet si një kosto shtesë operative? Prandaj do të doja që nga ana e Kuvendit të merreshin në konsideratë të gjitha mendimet dhe opinionet e ekspertëve të ndryshëm me qëllim që ky ligj në gjithë përmbajtjen e tij të garantojë që nuk ka shkelje të Kushtetutës dhe të lirive dhe të të drejtave të njeriut.

Nuk po zgjatem më shumë, por shpresoj që të gjitha këto mendime teknike që ofruam për ju të merren në konsideratë gjatë hartimit përfundimtar të projektligjit.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Peto, për opinionin tuaj ligjor!

Jeni e lutur të na e depozitoni edhe me shkrim!

Zhaklina Peto – Patjetër.

Ulsi Manja - Dua t'ju falënderoj, pasi gjatë gjithë këtyre dëgjësave që kemi zhvilluar gjatë këtyre ditëve, ky është rasti i parë ku kemi saktësisht një opinion ligjor që lidhet me përmbajtjen e projektligjeve, pra janë sugjerime dhe komente që i vlejné qëllimit të projektligjit. Depozitimi me shkrim do të na shërbente jo vetëm ne si komision, por relatorëve në mënyrë të veçantë për të pasqyruar aq sa munden në tekstin e projektligjit disa nga komentet që ju sapo bëtë.

Kush e do fjalën?

Po, zoti Luli.

Kujtim Luli – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar zotërinj deputetë,

Edhe unë si përfaqësues i prokurorisë jam dakord për miratimin në parim të dy projektligjeve, të cilat sjellin ndryshime dhe risi në plotësimin e kuadrit ligjor në të dyja fushat. Pa u zgjatur tek argumentet lidhur me miratimin në parim të dy projektligjeve, meqenëse këto projektligje nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejt me fushën dhe veprimtarinë e Prokurorisë. Lidhur me shqetësimet që ne kemi si Prokurori sa i takon medias dhe publikut, në aspektin teknik do t'ju sugjeroja disa ndryshime në projektligj me qëllim që të garantohet shmangia e problemeve dhe e shqetësimeve që ka prokuroria sa i takon publikimit të akteve të miratuara me ligj, qofshin këto akte që lidhen në kuadrin e hetimeve paraprake, mbrojtjen e dëshmitarëve dhe me sigurinë kombëtare.

Sa i takon projektligjit, që lidhet me ndryshimin e ligjit nr. 97, të vitit 2013, nenit 31, të shtuar, lidhur me detyrimet e OSHPE-ve, do t'ju sugjeroja përfshirjen e një paragrafi: “Publikimi i të dhënave dhe i akteve të ndaluara me ligj ndalohet”.

(Diskutime pa mikrofon)

Neni 31/1.

Besoj se është e qartë që në të gjitha publikimi i të dhënave dhe i akteve ndalohen me ligj, ligjet e posaçme i kanë të parashikuara rastet e ndalimit të publikimeve, të jetë pjesë edhe e këtij ligji, në mënyrë që të ndalohen nga publikimi i OSHPE-ve. Ky është nga ana e Prokurorisë sugjerimi teknik lidhur me këtë projektligj.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Luli!

A ka ndonjë koleg ndonjë gjë për të sqaruar me përfaqësuesit që janë të pranishëm të komision? Nuk ka.

Edhe për ju, zoti Luli, si përfaqësues i Prokurorisë së Përgjithshme, vlen e njëjta kërkesë, nëse është e mundur t'i kemi me shkrim opinionet e Prokurorisë së Përgjithshme në adresën e sekretarisë së Komisionit të Ligjeve, për t'i pasur në dispozicion përpara miratimit të projektligjeve.

Nëse nuk keni ndonjë gjë tjetër për të shtuar, ju falënderoj zonja Peto dhe Katro, si dhe zotin Luli për prezencën tuaj në komision dhe ju uroj ditë të mbarë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.12.2019, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Seancë dëgjimore me përfaqësues të shoqatave të mediave dhe gazetarët për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”” dhe projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Damian Gjikhuri, Aurora Mara, Ediola Braha, Elena Xhina, Adriatik Alimadhi dhe Andi Përmeti.

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Edmond Leka, Alban Zeneli, Elda Hoti, Nikolin Staka dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Elvin Luku – përfaqësues i Qendrës Shqiptare Media Look

Ilda Londo- përfaqësuese e Institutit Shqiptar të Medias

Kristina Voko- Drejtoreshë Ekzekutive e BIRN Albanias

Elona Gjylmi – Gazetar në A2CNN

Klesjana Omeri – Gazetar në Report TV

Ardit Hoxha – Gazetar në Panorama

Ulsi Manja – Vazhdojmë me dëgjuesën e radhës me shoqatën e medieve dhe gazetarët.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen e tyre Qendra Shqiptare Media Look, Instituti Shqiptar i Medies, BIRN Albania, si dhe kemi prezencën e disa gazetarëve.

A kanë ardhur përfaqësuesit?

(Diskutime pa mikrofon)

Ora nuk a vajtur ende, pasi e kemi lënë për në orën 13:00. Kështu që derisa të vijë ora bëjmë pushim dhe më pas do të rifillojmë mbledhjen e komisionit.

(Pas pushimit)

Ulsi Manja - Rifillojmë mbledhjen e komisionit për këtë pjesë të fundit të mbledhjes. Në rend dite kemi seancë dëgjimore me përfaqësuesit e shoqatave të mediave dhe gazetarëve për dy projektligjet e paketës antishpifje.

Sipas njoftimit që ka bërë sekretaria e Komisionit të Ligjeve, kanë konfirmuar pjesëmarrjen zoti Elvin Luku nga Qendra Shqiptare Media Look, zonja Ilda Londo nga Instituti i Shqiptar i Medias, një përfaqësuese nga BIRN Albania dhe një grup gazetarësh. Nuk e di nëse i kemi prezentë?

Me sa duket, edhe për shkak të faktit se komisioni përgjegjës i Mjeteve të Edukimit dhe Informimit Publik ka filluar që ditën e djeshme të zhvillojë seanca dëgjimore për të dy këto projektligje. Ishin edhe dje te ne në një mbledhje të përbashkët. Siç duket mund të jenë paraqitur te komisioni tjetër.

Gjithsesi, në përfundim të këtyre seancave dëgjimore për këto dy projektligje, projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97, datë 4. 3. 2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar””, si dhe projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19. 5. 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar””, Komisioni i Ligjeve, si komision për dhënie mendimi, hartoi një kalendar të posaçëm të dedikuar vetëm për shqyrtimin dhe miratimin e këtyre dy projektligjeve që njihen si paketa antishpifje.

Këto nisma janë depozituar në Kuvendin e Shqipërisë në muajin korrik të vitit 2019 dhe janë në procedurë parlamentare prej gati 6 muajsh. Në kuadër të transparencës me publikun, edhe në fazën e draftimit ka pasur tryeza pune për konsultimin me ekspertë të fushës, me grupe interesi, por pa diskutim edhe me ekspertë të huaj. Pas draftimit dhe depozitimit të nismave në Kuvend, ka pasur konsulencë të vazhdueshme me ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë me qëllim përmirësimin e këtyre dy drafteve.

Nga draftet e publikuara në faqen zyrtare të Kuvendit erdhëm në një variant të rishikuar të të dy drafteve. Kemi një draft të datës 20 nëntor të vitit 2019, që është bërë i njohur për kolegët deputetë, për opinionin publik, por edhe për përfaqësuesit e shoqërisë civile apo organizatat e tjera, mbi bazën e të cilit është zhvilluar diskutimi, por edhe dëgjesat që janë bërë në Komisionin e Ligjeve.

Unë dua të falenderoj kolegët e mi deputetë të Komisionit të Ligjeve, deputetët e tjerë që janë bërë pjesë e këtyre dëgjesave, si dhe relatorët, zonjën Bushka dhe zonjën Hysi, për përkushtimin në diskutimin e këtyre dy projektligjeve!

Kanë qenë disa seanca dëgjimore shumë interesante. Kemi zhvilluar seanca dëgjimore me përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe organizatave ndërkombëtare, me organizatat e shoqërisë civile, me Dhomën e Tregtisë dhe shoqatat e biznesit, me operatorët mediatikë, ku natyrisht kanë qenë prezente edhe shoqatat e mediave dhe gazetarët.

Sot kishim seancë dëgjimore me përfaqësues të fushës së gjyqësorit, prokurorisë, avokatisë dhe botës akademike. Natyrisht, pas zhvillimit të këtyre seancave dëgjimore, relatorët, por edhe këshilltarët e komisionit do të kenë në dispozicion të gjitha procesverbalet e zbardhura të dëgjesave, që janë regjistruar në audio gjatë këtyre ditëve.

I njëjti njoftim vlen për të gjithë përfaqësuesit që ishin në këto seanca dëgjimore, në mënyrë që opinionet e tyre me shkrim t'i depozitohen në sekretarinë e Komisionit të Ligjeve, por jo më vonë se ditën e hënë. Ditën e hënë Komisioni i Ligjeve do të bëjë shqyrtimin dhe miratimin nën për nen të këtyre dy projektligjeve, për t'i krijuar më pas mundësi Komisionit përgjegjës të Medias të mbyllë shqyrtimin dhe miratimin nën për nen të këtyre projektligjeve dhe më pas për t'ia kaluar seancës plenare për votim.

Unë besoj se Komisioni i Ligjeve do të marrë në konsideratë disa nga sugjerimet që janë bërë gjatë këtyre ditëve nga ekspertët vendas, por edhe opinionet e ardhura nga ekspertët ndërkombëtarë. E kemi bërë të qartë që në fillim që nuk kemi ngutje. Fakti që këto dy projektligje kanë rreth 6 muaj në procedurë parlamentare ka si qëllim të kemi dy projektligje që t'i shërbejnë më së miri interesit publik dhe gjetjes së një balance të duhur mes lirisë së shprehjes, lirisë së mediave, por edhe respektimit të të drejtave dhe lirive të qytetarëve në një shoqëri demokratike dhe të hapur.

Shumë faleminderit kolegëve, relatoreve dhe këshilltarëve të komisionit! Gjithashtu, dua të falenderoj të ftuarit, por edhe median, e cila gjatë gjithë këtyre ditëve ka transmetuar në mënyrë korrekte dhe të drejtpërdrejtë të gjitha mbledhjet e komisionit jo vetëm për këto dy projektligje, por për të gjithë axhendën e projektligjeve që janë shqyrtuar gjatë këtyre ditëve në komision, duke marrë në konsideratë edhe punën e palodhur që kanë pasur pas tërmetit të datës 26 nëntor 2019!

Edhe një herë unë gjej rastin të solidarizohem me familjet e viktimave, të dëmtuarit, por edhe me ata mijëra e mijëra qytetarë shqiptarë, që sot janë pa një banesë. Shumë shpejt ky komision do të ketë në tryezën e punës një ligj të rëndësishëm për përballimin e fatkeqësive natyrore si ajo e datës 26 nëntor. Garantoj edhe në emër të kolegëve që ky komision dhe Kuvendi i Shqipërisë do të jenë në krah të qeverisë për të kaluar çdo nismë ligjore që u vjen në ndihmë banorëve të prekur nga tërmeti.

Shumë faleminderit dhe ditë të mbarë!

Mbledhja e radhës dhe rendi i ditës do t'ju njoftohet nga sekretaria e komisionit nëpërmjet postës elektronike.

MBYLLET MBLEDHJA